



ROMA
INTEGRATION

Regional Cooperation Council

ANALIZA
E POLITIKAVE
GJITHËPËRFSHIRËSE QË
SYNOJNË INTEGRIMIN
E ROMËVE DHE
ASHKALIVE
NË KOSOVË*

Title: Analiza e politikave gjithëpërfshirëse që synojnë integrimin e Romëve dhe Ashkalive në Kosovë*

Botuesi: Regional Cooperation Council Roma Integration Action team
Ruzveltova 61, 11 000 Belgrade, Serbia

Tel: +381 (11) 4046 891

Fax: +381 (11) 4046 894

E-mail: romaintegration2020@rcc.int

Website: rcc.int/romaintegration2020/

Autorët: Ardita Metaj Dika

Redaktor: Orhan Usein

Redaktorë të
tjerë këshillues: Shejla Fidani

Dizajni: Samir Dedić

Shtypi: Kuća štampe, Belgrade

Tirazhi: 25

ISBN: ISBN-978-86-81358-21-4

ANALIZA E POLITIKAVE GJITHËPËRFSHIRËSE QË SYNOJNË INTEGRIMIN E ROMËVE DHE ASHKALIVE NË KOSOVË*

Përgjegjësia: Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal ose të pjesëmarrësve të tij, as të Bashkimit Evropian dhe Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur.


Shtator, 2020

* Ky emërtim është pa asnjë paragjykim për pozicionin ndaj statusit dhe është në përputhje me Rekomandimin e Këshillit të Sigurisë së OKB-së 1244/1999 (UNSCR 1244/1999) dhe Opininionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (ICJ) për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Tabela e përmbajtjes

Hyrje	6
Metodologjia	6
Përmbledhje ekzekutive	7
Legjislacioni dhe politikat	8
Punësimi	10
Arsimi	12
Shëndetësia	14
Strehimi	16
Gjetjet	17
Praktika të mira	21
Pengesat	22
Rekomandimet	22





Hyrje

Qëllimi kesaj analize është të sigurojë një vështrim të përgjithshëm të integritit të komunitetit Rom dhe Ashkali në politikat, programet, projektet dhe ndërhyrjet e qeverisë si dhe të identifikojë politikat gjithëpërfshirëse që mund të përfshijnë komunitetet Rom, Ashkali; të identifikojë pengesat e mundshme që Romët të përfitojnë nga politikat gjithëpërfshirëse; të identifikojë masa, përvoja dhe metoda të suksesshme ose premtuese me qëllim që të përgatiten politika, projekte dhe programe gjithëpërfshirëse për Romët dhe Ashkali; të ofrojë mendime për diskutim konstruktiv dhe të mbështetur në fakte për të dalë me veprime.

Politikat gjithëpërfshirëse janë strategji ose plane veprimi të miratuara nga qeveria qëndrore për të ndjekur objektivat në fusha të ndryshme. Këto politika synojnë të përmirësojnë kushtet e jetesës dhe mirëqenien e të gjithë qytetarëve. Megjithëse ato nuk i drejtohen ndonjë grupi të veçantë etnik, shoqëror ose të marginalizuar, këto dokumente kanë të bëjnë me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian sepse edhe ata përfitojnë nga këto politika. Përmirësimi i sistemit arsimor dhe i infrastrukturës shkollore, një sistem dhe shërbime më të mira të kujdesit shëndetësor, zhvillimi ekonomik dhe rritja e standardit të jetesës do të çojnë në mënyrë të pashmangshme në mirëqenien e të gjithë qytetarëve, përfshirë grupet e marginalizuara. Megjithëse këto të fundit, duke qenë në kufijtë e fundit të zhvillimit të shoqërisë, mund të mos përfitojnë aq shumë sa grupet më të privileguara.

Metodologjia

Për të realizuar këtë detyrë, është përdorur metodologjia e studimit cilësor. Është bërë analiza dhe vlerësimi i dokumenteve të ndryshme që lidhen me integrimin e komuniteteve Rom dhe Ashkali. Dokumentet e mëposhtme janë konsultuar: legjislacioni i plotë i Kosovës që ka të bëjë me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, strategjia aktuale dhe e mëparshme për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali dhe Planet e tyre të Veprimit, Korniza Europiane për Strategjitë për Integrimin e Romëve, Strategjia nacionale për Zhvillim dhe Plani i Veprimit, dokumente të ndryshme ndërkombëtare dhe qendror për politikat mbi integrimin e Romëve, raportet e OJQ-ve, artikujt e gazetarëve dhe artikujt e botës akademike.

Ky dokument përbëhet nga tre pjesë: Pjesa e parë paraqet elementët kryesorë dhe analizon legjislacionin në fuqi dhe politikat gjithëpërfshirëse që garantojnë të drejtat dhe përfitimet e komuniteteve jo-shumicë (pakicave) në Kosovë¹ me një fokus të veçantë tek Komunitetet Rom dhe Ashkali.

¹ Ky përcaktim nuk paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës

Pjesa e dytë ofron një prëmbledhje të politikave që rregullojnë sektorët kryesorë: arsimin, shëndetësinë dhe strehimin, dhe çështjet ndërsektoriale të barazisë gjinore dhe regjistrimit civil që ndikojnë drejtpërdrejt në situatën dhe mirëqenien e komuniteteve Rom dhe Ashkali në Kosovë.

Pjesa e tretë eksploron gjetjet, jep shembuj të praktikës së mire dhe jep rekomandime se si të procedohet.

Përmbledhje ekzekutive

Situata aktuale e komunitetit Rom dhe Ashkali në Kosovë, ashtu si edhe në vendet e tjera të Europës Lindore, kërkon me shume perkushtim të shqerise për të dëshiruar.

Komuniteti Rom në Kosovë përbëhet nga tre grupe të ndryshme etnike përkatësisht Romë, Ashkali dhe Egjiptianë. Të tre komunitetet ndryshojnë nga njëri-tjetri për sa i përket fesë, vendit të origjinës dhe gjuhës. Romët e Kosovës janë kryesisht të krishterë ortodoksë dhe flasin gjuhën roma (romani), shqipe ose gjuhen serbe si gjuhe të parë. Nga ana tjetër, Ashkalitë dhe Egjiptianët janë kryesisht myslimanë dhe flasin shqip. Romët besohet se kanë origjinë nga India, ndërsa Ashkalitë dhe Egjiptianët mendohet se janë respektivisht nga Siria dhe Egjipti.² Sipas Censurit të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, në Kosovë banojnë 35.784 Romë, Ashkali dhe Egjiptianë (8.824 Romë, 15.436 Ashkali dhe 11.524 Egjiptianë), kjo përbën 2% të popullsisë së përgjithshme.³

Politika kyçe per integrimin e Romeve eshte Strategjia dhe Plani i veprimit për Përfshirjen e komuniteteve Romë dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021⁴ e hartuar dhe aprovuar nga Qeveria e Kosovës në prill 2017. Strategjia përfshinë katër sektorë të rëndësishme: arsimi, punësimi dhe mirëqenies sociale, shëndetësia, dhe banimi.

Me përmasat e ndërmarra nga Qeveria dhe donatorët ndërkombëtarë dhe organizatat vendore ka ndikuar në përmirësimin e gjendjes së komuniteteve rom dhe ashkali. Kjo është dëshmuar edhe në raporte të Qeverisë së Kosovës* dhe raportin vlerësues për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropës-OSCE⁵.

² World Bank Systematic Country Diagnostic report, 2017, <http://documents.worldbank.org/curated/en/282091494340650708/pdf/Kosovo-SCD-FINAL-May-5-C-05052017.pdf>

³ World Bank, p.16 report Breaking the Cycle of Roma Exclusion in the Western Balkans. Available from: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/642861552321695392/pdf/Breaking-the-Cycle-of-Roma-Exclusion-in-the-Western-Balkans.pdf>.

⁴ https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/ANG-STRATEGJIA_PËR_PËRFSHIRJEN_E_KOMUNITETEVE_ROM_DHE_ASHKALI_NË_SHOQËRINË_KOSOVARE_2017-2021.pdf

⁵ https://www.osce.org/files/f/documents/6/7/443587_1.pdf



Sidoqoftë, edhe pse ka pasur përmirësime, hendeuku midis komuniteteve Rom dhe Ashkali mbetet ende i gjerë.

Legjislacioni dhe politikat

Strategjia e qeverisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali për periudhën 2017-2021, si dhe Plani i Veprimit për zbatimin e tij, është dokumenti më i rëndësishëm i politikave për përfshirjen e këtyre komuniteteve. Kjo politika kyçe e hartuar dhe aprovuar nga qeveria e Kosovës* e mbështetur tek strategjia e mëparshme dhe mësimet e nxjerra, që përfshinë katër sektorë Strategjia dhe Planet e Veprimit po koordinohen nga Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës* që gjithashtu koordinon punën e ministrive të përfshira të linjës dhe Organit Ndër-disiplinor për integrimin e Romëve.

Ashtu si strategjia e mëparshme, strategjia aktuale gjithashtu i përmbahet katër prioritetëve të përcaktuara nga Korniza e BE-së për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romëve. Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali është harmonizuar me politikat e tjera gjithëpërfshirëse, veçanërisht me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim⁶.

Qeveria e Kosovës* ka zhvilluar një kornizë ligjore dhe politika shumë të përparuara të bazuara në standarde dhe praktika më të mira ndërkombëtare për të gjitha komunitetet. Kushtetuta e Kosovës i njeh Rom, Ashkali dhe Egjiptian si tre bashkësi etnike të dallueshme që jetojnë në Kosovë*. Konventa Kornize për Mbrojtje e Pakicave Kombëtare është e zbatueshme në përfshirjen e saj në Kushtetutë. Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve (neni 9.2) në këtë nen specifikisht i referohet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi është i rëndësishëm për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, garanton dhe promovon parimet e barazisë dhe përfaqësimit të drejtë dhe tolerancës ndëretnike.

Kosova* ka legjislacionin e saj gjithëpërfshirës dhe të sofistikuar, i cili është harmonizuar në një masë të madhe me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Kushtetuta e Republikes së Kosovës* i parashikon mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si dhe garanton të drejtat e komuniteteve. Kushtetuta e Kosovës njeh popullsinë Rome, Ashkali dhe Egjiptiane si tre grupe të veçanta etnike që jetojnë në Kosovë*, ajo garanton përdorimin e gjuhës Rome si gjuhë zyrtare në nivel komune dhe garanton zbatimin e drejtpërdrejtë të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare.⁷

⁶ http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf

⁷ <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution%20Kosovo.pdf>

Politikat

Më poshtë paraqiten katër objektivat strategjikë në katër fushat prioritare nga Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare 2017-2021:

1. Rritja e përfshirjes dhe ofrimi i mundësive për zhvillim personal, trajnim dhe arsim për pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali;
2. Përmirësimi i situatës ekonomike dhe sociale të komuniteteve Rom dhe Ashkali;
3. Përmirësimi i gjendjes shëndetësore dhe cilësisë së jetës tek pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali;
4. Sigurimi i banimit të përshtatshëm të qëndrueshëm për komunitetet Rom dhe Ashkali në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Strategjia ka përcaktuar rezultatet e pritshme për secilin prej objektivave strategjikë dhe ka identifikuar aktivitetet dhe masat për arritjen e tyre.

Kjo strategji e trajton barazinë gjinore vetëm në një paragraf, duke vënë theksin tek situata e rëndë e grave Rome dhe Ashkali, që përjetojnë diskriminim të dyfishtë. Megjithatë, masat dhe veprimet për përmirësimin e situatës së tyre nuk janë të qarta.

Çështja e barazisë gjinore trajtohet si një çështje ndërsektoriale si në Strategji ashtu edhe në Planin e Veprimit Kosova* ka një legjislacion gjithëpërfshirës dhe të sofistikuar që është në përputhje me acquis të Bashkimit Evropian.

Kushtetuta e Kosovës* parashikon mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe garanton të drejtat e komuniteteve të saj. Kushtetuta njeh komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian si tre grupe të veçanta etnike që jetojnë në Kosovë* dhe u garanton atyre përdorimin e gjuhës rome si gjuhë zyrtare në nivelin komunal në lidhje me Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave.

Qeveria e Kosovës* ka zhvilluar një kornizë dhe politikë të përparuar ligjore të bazuar në standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira për të gjitha komunitetet. Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare është e zbatueshme me përfshirjen e saj në Kushtetutën e Kosovës*. Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve (neni 9.2) në këtë nen specifikisht u referohet Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve. Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi garanton dhe promovon parimet e barazisë, përfaqësimit të drejtë dhe tolerancës ndëretnike dhe është i rëndësishëm për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.



Punësimi:

Pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë grupi më i disavantazhuar në Kosovë*, siç tregohet edhe më mirë në tabelën e mëposhtme⁷:

Të ardhurat për frymë	Varfëri ekstreme (1 USD në ditë)	Niveli i papunësisë
Romë, Ashkali & Egjiptianë: 397€	Romë, Ashkali & Egjiptianë: 36.70%	Romë, Ashkali & Egjiptianë: 58.32%
Serbët: 1.282€	Serbët: 3.94%	Serbët: 30.18%
Shqiptarët: 1.051€	Shqiptarët: 12.87%	Shqiptarët: 45.85%
Të tjerë: 866 €	Të tjerë: 16.82%	Të tjerë: 42.96%

Duke parë informacionin e mësipërm, 10 vjet pas Shpalljes së Pavarësisë, komuniteti ndërkombëtar, pushteti vendor dhe qëndror dhe shoqëria civile kanë një rrugë të gjatë për të adresuar nevojat dhe kërkesat e komunitetit Rom dhe Ashkali.

Neni 9.2 i Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve parashikon se “Kosova*, krahas masave me synim të veçantë, zhvillon programe dhe iniciativa të tjera për punësim publik, që kanë synim të tejkalojnë diskriminimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të personave që u përkasin komuniteteve. Konsiderim i veçantë i kushtohet përmirësimit të gjendjes së komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian”⁸. Po ashtu, ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi është i rëndësishëm për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, megjithëse ato nuk përmenden në mënyrë të posaçme. Ky ligj garanton dhe promovon parimet e barazisë, përfaqësimit të drejtë dhe tolerancës ndëretnike.

Me qëllim uljen e varfërisë dhe zvogëlimin e rritjes së nivelit të papunësisë në mesin e pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali, që, në një shkallë të madhe, është rezultat i viteve të tëra të përjashtimit social, Ligji për Shërbimin Civil iu kërkon të gjitha institucioneve publike që minimumi 10% i pozicioneve në nivel kombëtar të jenë të rezervuara për pjesëtarët e pakicave, ndërsa në nivelin lokal punonjësit duhet të pasqyrojnë strukturën etnike të komunës në fjalë. Ligji për Shërbimin Civil, i miratuar në korrik 2010, është shfuqizuar dhe zëvendësuar me Ligjin për Zyrat e Publikë, i cili u dekretua në mars 2019. Ligji i ri ruan dispozitën e mëparshme që përcakton kuotën prej 10% për punësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë dhe synon krijimin e bazës ligjore për punësimin e zyretareve publike në institucione.

8 https://www.ecoi.net/en/file/local/1297112/1504_1261396548_law-on-the-protection-and-promotion-of-the-rights-of-communities-and-their-members-in-kosovo.pdf

Kështu, në mungesë të mënyrave më krijuese për të adresuar këtë çështje, kuotat e përcaktuara nga ligji mund të jenë një mjet për fuqizimin e Romëve dhe Ashkalive. Të dhënat sugjerojnë që Romët dhe Ashkalitë janë të nënpërfaqësuar në institucionet qendrore dhe lokale në krahasim me përqindjen e tyre në popullsinë e përgjithshme. Kjo mund të jetë kështu pjesërisht për shkak të nivelit të ulët të arsimimit dhe mungesës së kualifikimeve tek këto komunitete. Mungesa e kurseve afatshkurtra të kualifikimit ose e trajnimeve profesionale për pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali mund të jetë një arsye tjetër për nënpërfaqësimin e tyre në këto institucione publike.

Neni II i Rregullores Nr.04 / 2000 të Ministrisë së Administratës Publike i detyron institucionet publike të zbatojnë një larmi programesh trajnimi, të njohura si MAR (Masat Aktive të Rekrutimit) me qëllim pajisjen e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë me aftësitë e nevojshme dhe aftësimin e tyre për punë në këto institucione. Si pasojë, komunitetet e nënpërfaqësuar do të jenë në gjendje të plotësojnë kuotën prej 10%. Ndonjëherë, sfidat si mungesa e zotërimit të gjuhës angleze ose e aftësive themelore për përdorimin e kompjuterit mund të përbëjnë pengesa për punësimin.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim e Kosovës dhe Plani i Veprimit, i konsideruar si dokumenti kryesor i politikave për rritje ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm, është i ndarë në katër shtylla tematike: kapitali njerëzor, qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, zhvillimi i industrive konkurruese dhe zhvillimi i infrastrukturës. Ndërsa dokumenti shtjellon me detaje shumë çështje të rëndësishme për zhvillimin ekonomik, të cilat kanë të bëjnë shumë me komunitetet jo-shumicë, ai i përmend në mënyrë të posaçme këto komunitete në seksionin për forcimin e sistemit të të drejtave pronësore, brenda kapitullit të qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit. Kjo Strategji parashikon që “Strategjia Kombëtare për Zhvillim synon të fuqizojë sistemin e të drejtave pronësore duke u përqëndruar tek forcimi i kuadrut ligjor, nxitja e tregut të tokës, forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit për të gjykuar rastet e të drejtave të pronës dhe kryer aktivitete për të siguruar mbrojtje më të mirë të të drejtave të pronës për grupet e margjinalizuara, të tilla si komunitetet jo-shumicë si edhe të vajzave dhe grave”.⁹

Po ashtu, dokumenti përmend grupet e margjinalizuara dhe pranon rëndësinë e përfshirjes së tyre për zhvillimin ekonomik. Ai vë në dukje se nevoja që paralelisht me rritjen ekonomike të sigurohet edhe kohezion social dhe gjithëpërfshirje “nënkupton mospërjashtimin e grupeve të caktuara të shoqërisë nga përfitimet që rrjedhin nga rritja ekonomike”.¹⁰ Dokumenti vazhdon që “Gjithëpërfshirja është e domosdoshme jo vetëm për shkak se është parakusht për drejtësi dhe kohezion social, por edhe për shkak se si e tillë ajo bën të mundur rritje më të madhe dhe më të qëndrueshme ekonomike”.¹¹ Më tej, dokumenti identifikon pengesat e tjera me të cilat përballen

9 Po aty

10 Po aty

11 Po aty



grupet e marginalizuara, shpjegon shkaqet dhe propozon aktivitete për të trajtuar këto sfida. Disa nga sfidat e identifikuara janë puna në sektorin informal dhe sistemi gjyqësor joefikas që kontribuojnë në përjashtimin social të grupeve të marginalizuara.

Ky dokument i strategjisë është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës dhe ka për synim të krijojë një listë me prioritete, të identifikojë pengesat dhe të vlerësojë kapacitetet për zhvillim dhe rritje të qëndrueshme ekonomike. Ai nuk i referohet në mënyrë të posaçme komuniteteve Rom dhe Ashkali, por duke pasur parasysh qëllimet e këtij dokumenti, ai i përfshin edhe ato.

Arsimi

Provat sugjerojnë se ekziston një korrelacion pozitiv midis arsimit, të ardhurave dhe shëndetit. Një nivel më i lartë arsimor shoqërohet me përmirësimin e standardeve të jetesës, shëndetit, jetëgjatësisë dhe anashjelltas. Sa më i ulët të jetë niveli i arsimit, aq më pak ka të ngjarë që një person të gjejë punë. Analfabetizmi përkthehet në papunësi dhe papunësia përkthehet në varfëri, e cila përkthehet në shëndet të dobët dhe rritje të vdekshmërisë.

Plani Strategjik i Arsimit për vitet 2017-2021 është dokumenti bazë i politikave për zhvillimin e sektorit të arsimit në Kosovë*. Ky dokument trajton me detaje sfida e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në fushën e arsimit, përcakton objektiva të qarta dhe propozon aktivitete për kapërcimin e pengesave dhe lehtësimin e këtyre problemeve. Dokumenti identifikon shtatë objektiva strategjikë për sektorin e arsimit, pjesa më e madhe e të cilave përfshijnë edhe komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian ose në mënyrë të drejtëpërdrejtë, ose tërthorazi.

1. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja,
2. Menaxhimi i sistemit arsimor,
3. Sigurimi i cilësisë,
4. Zhvillimi i mësimdhënësve,
5. Mësimdhënia dhe të nxënësve,
6. Arsimi dhe Aftësi Profesional dhe arsimi i të rriturve,
7. Arsimi i Lartë

Objektivi Strategjik I synon rritjen e përfshirjes dhe ofrimin e mundësive të barabarta për zhvillim, trajnim dhe arsimim të çdo individit në arsimin parauniversitar. Ky është objektivi që ka më shumë lidhje me komunitetet Rom dhe Ashkali sepse ata janë më të prekurit nga mungesa e përfshirjes. Strategjia ka përcaktuar objektiva të prekshëm për pjesëmarrjen dhe përfshirjen e fëmijëve Rom

dhe Ashkali në arsimin parashkollor (objektivi: 70%), në arsimin fillor (objektivi: 95%), në arsimin e mesëm të ulët (objektivi: 85%) dhe në arsimin e mesëm të lartë (objektivi: 50%).

Në lidhje me këtë objektivi, strategjia ka parashikuar aktivitetet e mëposhtme: harmonizimi i programeve të qendrave mësimore; përgatitja e rregulloreve për të lehtësuar regjistrimin dhe ndjekjen e shkollimit të nxënësve Rom dhe Ashkali në arsimin parauniversitar; ofrimi i bursave për nxënësit në arsimin e mesëm; organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për rëndësinë e arsimit.

Strategjia përmend shkurtimisht “nxënësit që ndjekin shkollën në gjuhën serbe” dhe “nivelet e ulta të ndjekjes së shkollës” nga fëmijët e grupeve të marginalizuara, veçanërisht fëmijët Rom, Ashkali dhe Egjiptian si dy nga sfidat kryesore në këtë sektor.

Strategjia përmend mbështetjen e nxënësve Rom dhe Ashkali përmes partnerëve të shumtë përfshirë Komisioni Europian, Balkan Sunflowers, Roma Education Fund dhe Swiss Development for Cooperation, qeverinë gjermane me Ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, duke koordinuar projekte të ndryshme.

Kohët e fundit, MASHT-i ka rënë dakord të financojë një pjesë të këtij programi.

Strategjia identifikon vështirësi dhe pengesa specifike për përfshirjen dhe përfitimet e fëmijëve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë nga sistemi arsimor i integruar:

1. Mungesa e vullnetit të komunave për lehtësimin e kushteve të regjistrimit dhe të ndjekjes së shkollës nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në nivelin parashkollor dhe të mesëm, dhe
2. Mungesa e angazhimit efikas të ekipeve në nivel shkollor dhe komune për parandalimin e braktisjes.

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët janë të detyrueshëm në Kosovë*, në kuptimin që të gjithë fëmijët në moshë shkollimi të detyrueshëm duhet të regjistrohen në shkollë (në shkollë publike apo private të licencuara nga MASHT) dhe ta ndjekin atë rregullisht. Institucionet kosovare kanë përgatitur strategji që synojnë trajtimin e sfidave të braktisjes dhe të mosregjistrimit. Për këtë qëllim, në tetor 2014, MASHT-i miratoi një Udhëzim Administrativ që parashikon krijimin dhe forcimin e ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin e detyrueshëm. Ekipet e tilla, të njohura edhe si EPRBM-të (shkurtimi për Ekipet për Parandalim dhe Reagim kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit) janë ngritur në të gjithë Kosovën* dhe veprojnë në nivel shkollor dhe komune. Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim nxitjen dhe lehtësimin e aksesit në arsim për fëmijët e të gjitha komuniteteve, veçanërisht atyre më në nevojë që kanë nivele më të larta të braktisjes së shkollës dhe të mosregjistrimit.



Është detyrë e këtyre ekipeve të monitorojnë, identifikojnë, reagojnë dhe raportojnë rastet e mosregjistrimit ose të braktisjes. Ekipi fillimisht identifikon specifikat e çështjes në mënyrë që të hartojë një plan dhe t'i caktojë detyra anëtarëve të tij. Pastaj anëtarët e ekipit takojnë fëmijën, familjen e tij / saj, miqtë dhe grupet e tjera të interesit për të kuptuar arsyet e mosregjistrimit dhe të gjejnë mënyra për ta regjistruar fëmijën në shkollë.

Strategjia Nacionale për Zhvillim parashikon ndërhyrje që synojnë rritjen e regjistrimit të fëmijëve në arsimin parashkollor duke rritur numrin e kopshteve publike dhe përfshirjen në institucione private. Komunitetet Rom dhe Ashkali gjithashtu kanë të drejtë dhe mund të përfitojnë nga këto aktivitete dhe masa. Ndër të tjera, SKZh propozon ndërtimin e 18-të kopshteve për fëmijët në sistemin parashkollor, veçanërisht në komunitat në nevojë urgjente dhe që nuk kanë kopshte publike.

Përfshirja e kësaj grup moshe në arsimin parashkollor është vendimtare për zhvillimin kognitiv. Me të drejtë ky dokument vë në dukje se ka dallime ndërmjet zonave urbane dhe rurale në regjistrimin e fëmijëve në arsimin parashkollor. Këto dallime janë edhe më të dukshme në regjistrimin në sistemin në parashkollor të fëmijëve nga komunitetet shumicë dhe jo-shumicë. Kjo qasje është një mundësi për integrimin e politikave gjithëpërfshirëse për Romët në politikatat e gjithëpërfshirëse, kryesisht për integrimin e Objektivit Strategjik I (Arsimi) të Strategjisë për Përfshirjen e Komunitetit Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021 në Strategjinë për Zhvillim 2016-2021. Ky objektivi për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali synon rritjen e përfshirjes (në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm të lartë) dhe ofrimin e mundësive për zhvillim personal, trajnim dhe arsimim cilësor për pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali. Kjo strategji synon të rrisë pjesëmarrjen e fëmijëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali në arsimin parashkollor nga 53.9% (niveli bazë) në 70%. Po ashtu si SKZh-ja, strategjia propozon hapjen e klasave të parashkollorit në shkollat dhe kopshtet e lagjeve dhe zonave ku jetojnë popullsi Rome dhe Ashkali si masa për realizimin e këtij objektivi. Kështu, zbatimi i SKZh-së parashikon që ndërhyrja në fushën e arsimit do të ndihmojë në zbatimin e Objektivit Strategjik I të strategjisë.

Shëndetësia

Dokumenti prej 63 faqesh me titull “Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021” trajton shkurtimisht problemet shëndetësore të grupeve në nevojë, duke i përshkruar ato në mënyrë sipërfaqësore dhe në terma të përgjithshëm. Kjo strategji vetëm vë në sipërfaqen e një numri të madh të sfidat që rrethojnë grupet e marginalizuara në këtë fushë, nuk arrin të nxjerrë shkaqet kryesore të shëndetit të keq midis pjesëtarëve të këtyre grupeve dhe nuk parashikon ndonjë veprim ose masë praktike për të trajtuar problemet.

Strategjia vë në dukje që synon të përmirësojë aksesin e grupeve në nevojë në kujdesin shëndetësor pa e zgjeruar atë më tej. Me qëllim trajtimin e nevojave të grupeve të cënueshme, Ministria e

Shëndetësisë “po planifikon zhvillimin e shërbimeve të posaçme për fëmijët me nevoja të veçanta (autizmi, sindroma down), e projekte infrastrukturore për strehim për të sëmurët (ofrimi i shërbimeve për pacientët në fazat e fundit të jetës), përmirësimin e aksesit fizik për personat me aftësi të kufizuara në institucione publike të shëndetit, ndërtimin e Qendrës Klinike Universitare dhe të azilit për personat tetraplegjikë, adresimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore dhe të trafikimit të qenieve njerëzore si dhe forcimin e integritit të shërbimeve shëndetësore në burgje”, duke përmendur që “dështimi për trajtimin e problemeve të grupeve në nevojë do të sillte një pasojë negative në shëndetin e përgjithshëm të popullatës”.

Në vitin 2014 Kosova* miratoi Ligjin për Sigurimin Shëndetësor, i cili u dha të drejtën dhe detyrimin të gjithë qytetarëve të Kosovës* të kenë një “paketë bazë” të detyrueshme të sigurimeve shëndetësore që mbulon shërbimet emergjente të kujdesit shëndetësor, shtatzëninë dhe lehonat dhe shërbime të tjera thelbësore të kujdesit shëndetësor të përcaktuara nga Fondi. Deri më tani, sistemi i sigurimeve shëndetësore nuk është zbatuar.¹²

Ndërsa sistemi i kujdesit shëndetësor në Kosovë* është falas dhe i hapur për të gjithë qytetarët e tij, në praktikë kjo është e vërtetë kryesisht për sistemin e kujdesit shëndetësor parësor i cili ofron shërbimet bazë të kujdesit shëndetësor si dhe edukim shëndetësor, promovim dhe parandalim të sëmundjeve. Aksesin në institucionet e kujdesit shëndetësor sekondar dhe terciar shoqërohet me probleme. Sistemi shëndetësor publik nuk ofron shumë shërbime shëndetësore për shkak të mungesës së ekspertizës ose pajisjeve mjekësore. Për më tepër, disa teste të caktuara laboratorike dhe grafi nuk mund të bëhen në spitale për arsye të ndryshme, listat e pritjes janë shumë gjata, etj. dhe për këtë arsye pacientët detyrohen të kërkojnë ndihmë në sektorin privat, i cili është i kushtueshëm dhe i papërbalueshëm për shumë persona, veçanërisht për pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali dhe Egjiptian.

Treguesit e shëndetësisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e tyre reale në shoqëri. Shkalla e vdekshmërisë foshnjore midis fëmijëve Rom, Ashkali dhe Egjiptian vlerësohet të jetë 41 për 1000 lindje të gjalla (për krahasim, niveli i përgjithshëm i vdekshmërisë foshnjore në Kosovë* vlerësohet të jetë 12 për 1000 lindje të gjalla)¹³. Një në shtatë fëmijë nën moshën pesë vjeç që i përkasin komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian ishte shumë i vogël për moshën e tij. Jetëgjatësia ishte 58.3 vjet, dukshëm nën mesataren e pjesës tjetër të popullsisë. Megjithatë, në Strategjinë aktuale Sektoriale të Shëndetësisë nuk kishte vend për këto shifra tronditëse.

Në bazë të Ministris së Shëndetësisë dhe Institutit për Shëndet Publik-IKSH, te dhënat e fundit tregojnë se mbulueshmëria me imunizim e të gjithë fëmijëve te cilët jetojnë në Kosovë* pa dallim

12 <https://www.export.gov/article?id=Kosovo-Health-Industry#targetText=In%202014%20Kosovo%20adopted%20the,system%20has%20not%20been%20implemented.>

13 Unicef, Kosovo Programme <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/children-kosovo>



përkatësie etnike është mbi 95%. Janë vaksinuar 7786 fëmijë të tri komuniteteve rom ashkali dhe egjiptase sipas të dhënave të IKSHP. Kurse të dhenat lidhje me vaksinimin të cilët janë përfshi në analize janë nga Anketa e Grupit të Treguesve të Shumëfishtë të Kosovës* (MICS) 2014.

Sa i përket vaksinimit, vetëm 30% e fëmijëve nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë plotësisht të vaksinuar sipas skemës së vaksinimit në Kosovë*, ndërkohë që ky mbulim është deri në 80% për pjesën tjetër të popullatës.

Dokumenti i vetëm gjithëpërfshirës për shëndetin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian që trajton të gjitha fushat me interes për këto komunitete është Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali, e cila mesa duket nuk është në përputhje me Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë të Ministrisë së Shëndetësisë.

Strehimi

Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë* (SKDP) synon të adresojë, forcojë dhe sigurojë të drejtat e pronës për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Qëllim i SKDP-së është të ofrojë vizionin strategjik për sigurimin e të drejtave. Ai i jep përparësi dhe rendit ndërhyrjet për të përcaktuar qartë të drejtat e pronës në ligj dhe për të siguruar mekanizma të arritshëm, efikas dhe të përballueshëm përmes të cilit njerëzit mund të marrin njohuri ligjore të të drejtave të tyre dhe më pas të zyrtarizojnë të drejtat e tyre përmes regjistrimit në kadastër. Të drejtat e zyrtarizuara dhe të regjistruara në kadastër mund të zbatohen në mënyrën më efikase dhe konsistente nga gjykatat dhe agjencitë qeveritare duke ofruar një siguri më të madhe. Për të ofruar të drejta të sigurta për të gjithë, SKDP njeh sfidat me të cilat ballafaqohen gratë, personat e zhvendosur dhe pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë për të ushtruar plotësisht në praktikë të drejtat e tyre mbi pronën dhe propozon masa specifike për të adresuar këto sfida.

Sipas Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2017-2021, nevoja për strehim e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve është vlerësuar rreth 6.000 banesa. Duke marrë parasysh se sipas censusit të fundit të regjistrimit të popullsisë ishin rreth 36.000 pjesëtarë të këtyre tre komuniteteve, kjo do të thotë që një në çdo gjashtë Rom, Ashkali dhe Egjiptian kanë nevojë për një lloj strehimi.

Për këtë qëllim, Parlamenti i Kosovës* ka miratuar Ligjin për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, me qëllim "krijimin e kushteve për banim të qëndrueshëm për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave si dhe caktimin e mënyrës së sigurimit dhe shfrytëzimit të mjeteve financiare për zhvillimin e programeve të veçanta të banimit." Ky ligj përfshin të gjithë njerëzit që janë në gjendje të skajshme ekonomike.

Ofrimi i banesave sociale është përgjegjësi e komunave dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të ligjit. Sipas nenit 25, komunat duhet të hartojnë programe dhe projekte trevjeçare për banim.

Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit është ende në fuqi.¹⁴ Sipas Raportit të Auditimit mbi zbatimin e këtij ligji në nivel vendor për periudhën 2013-2017¹⁵ në komunat e Kosovës* janë mbështetur një numër i përgjithshëm prej 444 kërkesash për banesa sociale nga pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Sipas raportit vjetor qeveritar të monitorimit të Planit të Veprimit për Integrimin e Romëve, pesëmbëdhjetë komuna hartuan programet tre-vjeçare, nëntë i miratuan ato, por vetëm katër punuan në të vërtetë në projekte specifike.

Megjithëse janë përgatitur një numër aktesh nënligjore për të mbështetur zbatimin e këtij ligji, në prill 2015 qeveria e Kosovës* miratoi Koncept Dokumentin për Banim Social¹⁶ për amendimin e ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit për shkak të kompleksitetit të legjislacionit, mangësive dhe vështirësive në zbatim. Në këtë drejtim nuk janë marrë vendime të mëtejshme.

Gjetjet

I. Hartuesit dhe zbatuesit të politikave, të projekteve dhe programeve që synojnë komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, politikëbërësit dhe organizatat përkatëse të shoqërisë civile shpesh i anashkalojnë 10 Parimet e Përbashkëta Bazë (PPB)¹⁷ për përfshirjen e këtyre komuniteteve. Kjo është e vërtetë veçanërisht për Parimin 2 dhe 4 të PPB-së. Shumë rrallë shohim që politika dhe ndërhyrje të përqëndruara tek komunitetet Rom dhe Ashkali të shtrihen përtej popullatës së synuar të tyre dhe të përfshijnë grupe të tjera të marginalizuara, gjë që i bën këto plane dhe veprime të qarta dhe përjashtuese për komunitetet e tjera, në kundërshtim me "frymën" e Parimit 2 që iu kërkon atyre të jenë të qarta, por jo ekskluzive. Për më tepër, janë bërë pak përpjekje për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian të përfitojnë nga nisma për politika më të gjera, në kuptimin që aktorët përkatës nuk kanë arritur të kenë si qëllim integrimin. Organizatat e shoqërisë civile Rome, Ashkali dhe Egjiptiane merren kryesisht me qasje që synojnë promovimin e përfshirjes së Romëve dhe nuk i kushtojnë vëmendjen e duhur idesë së bërjes së politikave gjithëpërfshirëse që përfshijnë edhe Romët. Ne anën tjetër, Qeveria e Kosovës* ka hartuar një legjislacion gjithëpërfshirës si Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve

14 [https://mmph.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/pdf-test%20\(48\).pdf](https://mmph.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/pdf-test%20(48).pdf)

15 file:///C:/Users/PC/Documents/Downloads/RaportiAuditimit_PVB_Shqip.pdf

16 file:///C:/Users/PC/Documents/ROMA%202/KD_Banim_Social_-_MMPH.pdf

17 <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/7573706d-e7c4-4ece-ae59-2b361246a7b0>

dhe anëtarëve të tyre në Kosovë*, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji për përdorimin e gjuhëve dhe mekanizmat e tjerë siç është Këshilli Konsultativ për Komunitetin, dhe kuota për përfshirje në Institucionet e Kosovës*.

2. Kuota prej 10 përqind, i cili është mbështetur në Ligjin e ri për Zyrtarët Publikë, e bën më të lehtë për anëtarët e komuniteteve pakicë për të gjetur një punë në sektorin publik, veçanërisht për ata me arsim të lartë. Ndërsa kjo formë e pohimit pozitiv është provuar të jetë një mjet efektiv për uljen e papunësisë dhe fuqizimin e komuniteteve pakicë në përgjithësi, në kundërshtim me pritjet, të dhënat zbulojnë se anëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali nuk përfitojnë nga kuota e përmendur.


3. Vlerësimi i punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në Shërbimin Civil (ShC) dhe ndërmarrjet publike në Kosovë*, të botuar nga zyra e kryeministrit/Zyra për Çështje të Komuniteteve në maj 2013, është dokumenti më i gjerë mbi punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Ky vlerësim analitik i thelluar i përfaqësimit të komuniteteve jo-shumicë në shërbimin civil në Kosovë* u krye me qëllim që të paraqitet një pasqyrë më e saktë e përfaqësimit të komuniteteve jo-shumicë në shërbimin civil të Kosovës* dhe ndërmarrjet publike (NP) si edhe një vlerësim i shkallës së zbatimit të ispozitës vendore për 10 përqind kuota për komunitetet jo-shumicë. Përveç të qenit analitik, studimi është gjithashtu edhe krahasimor, sepse ai krahason gjendjen aktuale me atë të vitit 2010.

Punësimi i komuniteteve jo-shumicë në institucionet në nivel qendror dhe vendor në 2013 ishte 7.7%. Po ashtu, Romët dhe Ashkalitë janë relativisht të nënpërfaqësuar në krahasim me përqindjen e tyre në popullatën e përgjithshme. Situata në ndërmarrjet publike (NP) është edhe më pa kenaqeshme (me pjesëtarë të komuniteteve jo-shumicë që përbëjnë vetëm 2.2% të punonjësve në këto kompani). Ka një prirje të vogël negative në krahasim me të dhënat e raportuara në vitin 2010 mbi përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë në ndërmarrjet publike. Gjithësesi, përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë në shërbimin civil në pushtetin vendor është përmirësuar në krahasim me të dhënat e raportit në vitin 2010 (nga 5.5% në 8.8%).

Të dhënat e fundit tregojnë se ndërkohë që punësimi i komuniteteve jo-shumicë është rritur dhe ka kaluar kuotën prej 10%, kjo rritje ka qenë në një masë të madhe në përpjestim të zhdrejtë. Raporti i vitit 2018 mbi Situatën e Shërbimit Civil në Kosovë* të përgatitur nga Departamenti i Administratës së Shërbimit Civil zbuloi se në 2017 komunitetet jo-shumicë përbënin më shumë se 11% të punonjësve të shërbimit civil në nivel vendor dhe qendror.

Tabela më poshtë tregon përbërjen e Shërbimit Civil të Kosovës* në nivel qendror dhe lokal në vitin 2017, të zgjedhur sipas grupeve etnike:

Kjo tabelë tregon se komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian ka përfituar më pak nga politika e kuotës prej 10%.



Prandaj duhet të merren masa për të garantuar që përbërja e shërbimit civil të pasqyrojë diversitetin e komuniteteve në Kosovë* dhe kuota prej 10% të ndahet në mënyrë të drejtë ndërmjet komuniteteve jo-shumicë në mënyrë proporcionale me përqindjen e tyre në popullsinë e përgjithshme.

4. Pjesëtarët e grupeve të marginalizuara, përfshirë pjesëtarët e komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, kanë më shumë gjasa të përfundojnë në punë në sektorin informal ku ata paguhën më pak, nuk gëzojnë mbrojtje ligjore dhe sigurime shëndetësore, duke iu nënshtruar kushteve të pasigurta të punës, etj. **Transformimi i punës së padeklaruar të Romëve në një ekonomi të rregullt të tregut duhet të futet në Kosovë*.**

5. Pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali vuajnë nga një shëndet më i dobët se popullata shumicë. Kjo është e vërtetë për komunitetet dhe ndodh kështu për shkak të përjashtimit sistematik. Por rol luajnë edhe nivelet e ulëta të arsimit, kushtet e dobëta të jetesës, mungesa e edukimit shëndetësor, etj. Aktualisht, nuk ka programe shëndetësore të posaçme për komunitetet Rom dhe Ashkali dhe grupe të tjera në nevojë. **Qeveria duhet të punojë për përgatitjen e programeve specifike të përshtatshme për nevojat e grupeve në nevojë. Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë duhet të përshtatet dhe të harmonizohet me Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali.**



6. Regjistrimi civil dhe fëmijët e peregjistruar janë një sfidë e madhe dhe e përhapur në vendet pas konfliktit. Ky problem vazhdon për vite me radhë edhe pas përfundimit të konfliktit për shkak të mos regjistrimit, për shkak të problemeve që lidhen me mos regjistrimit etj.

Kosova* ka ndërmarrë masa kundër mungesës së shtetësisë në përputhje me konventat më të njohura ndërkombëtare për parandalimin e pashtetësisë. Institucionet angazhohen për përmirësimin e legjislacionit dhe të zbatimit të ligjeve të cilat synojnë për të parandaluar pa shtetësinë për fëmijët; angazhohen për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e regjistrimit të fëmijëve menjëherë pas lindjes në mënyrë që asnjë fëmijë të mbeten të peregjistruar.

Ligji i Kosovës* për Shtetësinë përmban dispozita që lehtësojnë fitimin e shtetësisë.

Mungesa e ndërgjegjësimit për rëndësinë e regjistrimit dhe pamundësia për të paguar tarifat administrative janë arsyt kryesore për numrin e lartë të fëmijëve të peregjistruar në mesin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Një raport i UNHCR-së deklaron se 618 pjesëtarë të këtyre komuniteteve, afërsisht 2.5 për qind, ishin në rrezik për të qenë pa shtetësi. Nga ky numër, 65% e tyre ishin fëmijë.¹⁸

Sipas Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria çdo vit u dërgon një letër njoftimi komunave në Kosovë* për të deklaruar muajin Prill si falas për regjistrimin e personave të peregjistruar dhe fëmijëve të lindur jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme po monitorojnë regjistrimin e gjendjes civile bazuar në dy udhëzime administrative nr. 24/2015 dhe nr. 17/2015 lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ky informacion duhet të jetë më i dukshëm dhe i disponueshëm në mesin e komuniteteve romë.

7. Shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor, sekondar dhe terciar janë të hapura dhe falas për të gjithë banorët në Kosovë* (përfshirë fëmijët e peregjistruar). Asnjë personi nuk i mohohet aksesit në shërbimet e kujdesit shëndetësor në sektorin publik të shëndetësisë por sfida është se shumë procedura për diagnostikim dhe terapi nuk kryhen fare në sektorin publik. **Fëmijët e peregjistruar mund të marrin trajtim dhe kujdes në spitalet private, por ata duhet të paguajnë për këto shërbime. Qeveria duhet të prezantojë një sistem dhe të përballojë kostot për grupet e cënueshme që nuk janë në gjendje të përballojnë shërbimet.**

8. Politikat për përfshirjen e Romëve nuk i kanë kushtuar vëmendjen e duhur komunikimit publik, i cili mund të luajë një rol kryesor në pranimin më të madh në shoqëri.

18 <https://www.unhcr.org/ibelong/kosovo-joint-strategy/>

9. Kur bëhet fjalë për dimensionin gjinor, politikat gjithëpërfshirëse nuk arrijnë të adresojnë çështjen e mbështetjes së fëmijëve dhe trajtojnë në një shkallë të vogël dhunën në familje dhe trafikimin. Ndërsa në Strategjinë për Gjithepërfshirjen e komuniteteve Romëve dhe Ashklike, nuk përmendet mbështetja e fëmijëve, **çështjet e dhunës në familje dhe trafikimit përmenden në një fjali të vetme**, tek fushata informuese për skemën e mirëqenies sociale dhe ofrimin e shërbimeve sociale, duke parashikuar se “OJQ-të duhet të informojnë gratë dhe fëmijët e këtyre komuniteteve për të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion në rastet e dhunës në familje”.¹⁹

Praktika të mira

1. Vendorsja e kuotave si një praktikë e mirë - politika e kuotave nuk ka provuar të jetë një mjet efikas në zbutjen e pabarazisë dhe të papunësisë midis pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkali, megjithëse ka ofruar mundësi punësimi për ta. Megjithatë, politika e kuotave është e dobishme dhe duhet të vazhdojë të zbatohet, ndërsa zbatuesit duhet të sigurojnë që çdo pakicë të përfaqësohet sipas përqindjes së saj në popullsinë e përgjithshme.

2. Një projekt i 40 Qendrave Mësimore me bazë në komunitet, i përgatitur nga organizatat e shoqërisë civile me mbështetjen financiare të donatorëve të huaj vepron në 15 komuna të Kosovës* që nga viti 2000. Qëllimi është përmirësimi i performancës së shkollës, parandalimi i braktisjeve, sigurimi i edukimit për shëndetin seksual dhe riprodhues, etj. Ky projekt është i qartë, por jo përjashtues. Është i qartë në kuptimin që ka në qendër të tij fëmijët e komuniteteve jo-shumicë, kryesisht Rom, Ashkali dhe Egjiptian, por është i hapur edhe për fëmijë nga të gjitha komunitetet, fëmijë që ose nuk ndjekin shkollën, ose janë në rrezik për braktisjen e saj. Me kalimin e viteve, Qendrat Mësimore janë bërë një storie suksesi aq e madhe sa që ato janë integruar në sistemin arsimor. Në mënyrë që të mbështesë studentët nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian për të përmirësuar performancën e tyre, MASHT ka zhvilluar një Udhëzim Administrativ 19/2018 që sqaron përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për krijimin dhe funksionimin e Qendrave të Mësimin, përmes të cilave ofrohet arsim shtesë për studentë të komuniteteve. Qëllimi i këtij Udhëzimi është të ndihmojë organizatat e shoqërisë civile ose komunat që dëshirojnë të krijojnë ose të vazhdojnë të drejtojnë Qendra Mësimore. Për të regjistruar një qendër mësimore, aplikanti duhet të plotësojë disa kushte dhe kriterë të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ.

3. Ekipeve të parandalimit dhe reagimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit mbajnë informacione mbi frekuentimin e nxënësve në mësim dhe pasi marrin informacion që një nxënës braktis shkollën ata kontaktojnë me fëmijën dhe familjen e tij / saj dhe përpiqen t'i bindin ata të mos e bëjnë këtë.

4. Komisioni Komunal për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar koordinohet nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe në sajë të punës së tyre dhe punës së drejtorive

19 http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/ANG-STRATEGJIA_P%C3%8BR_P%C3%8BRFSHIRJEN_E_KOMUNITETEVE_ROM_DHE_ASHKALL_N%C3%8B_SHOQ%C3%8BRIN%C3%8B_KOSOVARE_2017-2021.pdf



përkatëse arsimore në nivel komune, ofroje mundësi që të gjithë fëmijët e të kthyerve janë riintegruar shpejt dhe lehtë në sistemin arsimor.

5. Prizreni është komuna e parë që në sistemin e arsimit fillor po ofron klasa në gjuhën rome dhe po ofron mësim mbi historinë dhe kulturën rome.

Pengesat

1. Mungesa e arsimit kufizon mundësitë e punës. Arsimi është i rëndësishëm për fuqizimin individual dhe kolektiv. Shumë fëmijë nga keto komunitetet në nevojë janë në punë për të ndihmuar familjet e tyre.

2. Për më tepër, martesat në moshë të vogël e vajzave nuk e ndihmon as çështjen e arsimit. Kjo çështje e ndjeshme kërkon një qasje gjithëpërfshirëse. Masat dhe ndërhyrjet e duhura mund të japin rezultate të mëdha. Masave/ndërhyrjeve për trajtimin e kësaj çështjeje janë shpërblimet e dhëna nga qeveria dhe komunat përmes granteve për nxënësit dhe ndihmave për familjet përmes fushatave ndërgjegjësuese për rëndësinë e arsimit dhe kundër martesave të hershme.

3. Pengesa më e zakonshme për të gjetur punë në sektorin privat është mungesa e përvojës së mëparshme. Kjo është një situatë ku shumë të rinj (përfshirë ata nga komuniteti i shumicës) e gjejnë veten. Ndonjëherë, kjo kërkesë mund të përdoret si justifikim për të mos punësuar pjesëtarë të komuniteteve jo-shumicë. Sidoqoftë, kuota 10 përqind duhet të bëjë më të lehtë për Romët dhe Ashkalitë të arsimuar të fitojnë një vend pune në institucione publike.

4. Shumica e organizatave të shoqërisë civile që merren me çështje me interes për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian nuk kanë kapacitetet dhe njohuritë e nevojshme për të zbatuar projekte komplekse dhe për të synuar për arritjen e integritimit.

Rekomandimet

1. Të sigurohet kuptim dhe zbatim më i mirë i Parimeve të Përbashkëta Bazë për Përfshirjen e Romëve, duke i kushtuar vëmendje të posaçme Parimit 2 – Synimi për Integrimin²⁰
2. Në mënyrë që të përfshihet përfshirja e romëve në programe të përgjithshme, projekte dhe ndërhyrje, duhet të sigurohet zhvillimi i kapaciteteve dhe shkëmbimi i ndërhyrjeve praktike për palët e interesuara.

²⁰ ec.europa.eu Substantive policies on Roma integration - Recommendations to Member States

3. Të sigurohet përmendje specifike e Romëve dhe grupeve të tjera vulnerabël në të gjitha dokumentet e politikave gjithëpërfshirëse që trajtojnë përfshirjen sociale.
4. Të ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm për zbatimin e programeve të trajnimit profesional dhe të rritet regjistrimi i pakicave në këto programe.
5. Të garantohet që pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkali të informohen në lidhje me trajnimet në dispozicion dhe mundësitë për punësim që janë të hapura për të gjithë qytetarët.
6. Transformimi i punës së padeklaruar të Romëve në një punë të deklaruar duke e bërë kryerjen e punës së deklaruar më të dobishme dhe më të lehtë për punëdhënësit dhe punonjësit.
7. Të luftohet kundër diskriminimit të dyfishtë të grave përmes vendosjes së kuotave për gratë Rome dhe Ashkale në punësim dhe rritjes së skemave të granteve dhe bursave.
8. Autoritetet përkatëse duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të siguruar harmonizimin më të mirë të strategjive për përfshirjen e Romëve me politikën për arsimin, punësimin, shëndetin publik dhe strehimin.
9. Ekspertët e politikës së strehimit duhet të drejtohen nga Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Pronës që siguron të drejta të sigurta dhe njeh sfidat me të cilat përballen gratë, personat e zhvendosur dhe anëtarët e komuniteteve jo-shumicë kur planifikojnë masat e strehimit për komunitetet rome dhe ashkali.
10. Mbledhja e të dhënave për strehimin, hartëzimi të nevojave të vendbanimeve rome duhet të bëhet një praktikë e rregullt e institucioneve përgjegjëse të drejtuara nga Ministria e Linjës e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
11. Zhvillimi i programeve, sigurimi i fondeve dhe sigurimi i banesave sociale për të qenë përgjegjësi sistematike e komunave.
12. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të sigurojë monitorim për zbatimin e Ligjit për Financimin e Strehimit për Programet Specifike.
13. Agjencia e Regjistrimit Civil për të lehtësuar marrjen e shtetësisë për personat e paregjistruar dhe për të siguruar këshilla ligjore për lëshimin e dokumenteve të regjistrimit civil duke zbehur ndërgjegjësimin dhe promovuar legjisllacionin emocionues të lartpërmendur.



14. Autoritetet përkatëse dhe shoqëria civile duhet të shtojnë përpjekjet e tyre për të rritur aktivitetet e tyre për të informuar komunitetet për mundësinë për të casur shërbimet shëndetësore sic janë vaksinimin, kontrollin për sëmundje të ndryshme, shëndetin riprodhues të grave dhe punën e këshillimit social-shëndetësor dhe këshillues dhe të klinikave të lëvizshme.
15. Hartimi i programeve mësimore specifike mbi kulturën dhe historinë rome, ashkali dhe egjiptiane dhe të vendos atë në sistemin arsimor. Kjo do të jete hap drejtues që do të çojë në promovimin e anti-diskriminimit dhe luftimin e paragjytimeve.
16. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe komunat përkatëse duhet të marrin pronësinë dhe të financojnë së bashku Qendrat Mësimore. Ministria duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të shtuar Qendrat Mësimore edhe në komuna të tjera.
17. Në thelb, çdo politikë e integruar duhet të përdoret për të shtyrë përpara perfshirjen e këtyre komuniteteve. Politikat e perfshirjes kanë mundësinë (pa u përshtatur për grupe të caktuara të marginalizuara) t'i shërbejnë kauzës së perfshirjes të komunitetit Rom pasi shumica e tyre ndërthuren me planet për integrimin e Romëve dhe Ashkalive:
 - a. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 e Kosovës* që ka në qendër kapitalin njerëzor dhe arsimin dhe parashikon ndërhyrjet në regjistrimin e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies në arsimin parauniversitar;
 - b. Harmonizimi i strategjive sektoriale të shëndetësisë, arsim, punësim dhe banimit me objektivat e perfshirjes së komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian;
 - c. Sektori i shërbimit civil – duhet të vendose politikat për kuotat – duke garantuar që Rom dhe Ashkali të përfitojnë nga politika e kuotës prej 10% në përputhje me përqindjen e tyre në popullatën e përgjithshme.



Roma Integration Action Team Office

Ruzveltova 61, 11000 Belgrade, Serbia
T: +381 (11) 4046 891 F: +381 (11) 4046 894



rcc.int/romaintegration2020



[RomaIntegration2020](https://www.facebook.com/RomaIntegration2020)



[RomaIntegration](https://twitter.com/RomaIntegration)



Regional Cooperation Council

Regional Cooperation Council Secretariat

Trg Bosne i Hercegovine 1/V
71000 Sarajevo, Bosnia and Herzegovina
T +387 33 561 700 F +387 33 561 701 E rcc@rcc.int



rcc.int



[RegionalCooperationCouncil](https://www.facebook.com/RegionalCooperationCouncil)



[rcc.int](https://twitter.com/rcc.int)



[RCCSec](https://www.youtube.com/RCCSec)



[RegionalCooperationCouncil](https://www.linkedin.com/company/RegionalCooperationCouncil)

Co-funded by
the European Union



**OPEN SOCIETY
FOUNDATIONS**